
Lënda: Informacion i pjesshëm në lidhje me inspektimin e objekteve të finacuara nga Bashkia Tiranë, për periudhën kohore nga viti 2010 deri në vitin 2018

Objekti: Ndërtimi i rrugës "Faik Konica", Tiranë

Investitori: Bashkia Tiranë

Vlera e Investimit: 112,526,108 lekë

Periudha kohore: Janar 2017, deri në maj 2018

Inspektimi është kryer: Shkurt 2019

Ky objekt zbatohet në qytetin e Tiranës, në një rrugë të pozicionuar në anën Lindore të stadiumit "Qemal Stafa", në kufirin e ndërtimeve me zonën e Parkut të Madh të Tiranës. Segmenti rrugor nis nga bashkimi i rrugës "Faik Konica", me rrugën që rrethon stadiumin "Qemal Stafa" dhe përfundon në bashkimin e këtij segmenti rruge me rrugën "Gjeneral Nikols", me një gjatësi të përgjithshme të saj, rreth 370 ml (metër linear). Gjendja ekzistuese e rrugës, një pjesë ka qenë ndërtim rruge tërësisht e re dhe një pjesë rikonstruksion, e zgjerim i saj.

Projekti ka ndërhyrë në rehabilitimin e gjithë shtresave rrugore të trupit të rrugës (shtrimi me pllaka guri dekorativ), në rehabilitimin e nënshtresave të trupit të rrugës me të gjitha komponentët e saj (shtresë betoni + çakëll + stabilizant) në gjithë të gjatësinë e saj, në rehabilitimin e rrjetin të ujërave të bardha, me sistemimin e kanalizimeve të ujërave të zeza, në sistemimin e trotuareve, në rehabilitimin e rrjetin të ndriçimit, në sinjalistikë rrugore, rehabilitimin e mureve mbajtëse dhe pritese të rrugës, etj. Projekti i zbatimit ka parashikuar një rikonstruksion të plote të këtij segmenti rrugor.

Punimet kanë filluar në muajin janar 2017, ndërkohë inagurimi për përfundimin e saj është bërë në muajin maj 2018, që përkon edhe me përfundimin e deklaruar nga Bashkia Tiranë. Afati i garancisë së punimeve për këtë objekt ndërtimi është dy vjet. Pra rezulton se afati kohor i garancisë së punimeve të veprës, ende nuk ka përfunduar dhe vepra është brenda afatit të kësaj ganacie. Zbatimi i punimeve është bërë në kushte optimale, pasi rruga gjatë periudhës së ndërtimit të saj ka qenë pothuajse e bllokuar.

Duhet të përmendim se për këtë segment rrugor janë përdorur veshjet me gurë dekorativ, si për trupin e rruges edhe në trotuaret anesore të saj. Për ndërtimin e rrugëve me veshje guri, jemi të mendimit se ka një kosto shumë të lartë (aktualisht vlera e ndërtimit të saj ka një kosto rreth 3 herë më të shtrenjtë se mesatarja e ndërtimeve të rrugës me shtresë asfalto-betoni).

Ndërtimi me gurë dekorativ nuk i është përshtatur aspak objekteve të ndërtuara pranë saj. Investitori dhe projektuesi duhet të japin të gjithë argumentet e nevojshëm, se kush është qëllimi që e kanë ndërtuar rrugën me veshje guri dekorativ (apo është thjesht plotësim dëshire e ndonjë individi të caktuar).

Nga pamja vizuale e objektit konstatojmë se:

- Në trupin e rrugës, në pjesën e kalimit të makinave, u vunë re lëvizje të pllakave të gurëve dekorativ, si edhe thyerje të tyre;
- Nuk shohim lidhje funksionale të shtresave të rrugës apo të trotuareve të saj, me muret mbajtës të kësaj rruge (ato janë ndërtuar me beton dhe nuk janë veshur me pllaka guri, për të patur një uniformitet të njëjtë i gjithë segmenti rrugor;
- Trashësia e pllakave të shtruara nuk është uniformë (ka diferenca të trashësisë së tyre). Një pjesë e banorëve që frekuentonin kalimin e kësaj rruge, u ankuan për rrëshqitjen e tyre gjatë periudhes së ngricave dhe vështirësi kalimi në të.



Fig. 1
Pllaka te demtuara dhe te riparuar.

Edhe pse objekti ka më pak se një vit që është përfunduar, cilësia e punimeve të ndërtimit të veprës mund të vlerësohet në nivele mesatare. Bashkia Tiranë, si investitore e këtij objekti, ka gjithë detyrimin ligjor për kontrollin e zbatimit të punimeve të ndërtimit (në cilësi dhe sasi). Jemi të mendimit se nga mbikëqyrësi i punimeve, por edhe nga Bashkia Tiranë, ka patur neglizhencë gjatë marrjes në dorëzim të punimeve të këtij segmenti rrugor, me vlerë investimi shumë të konsiderueshëm.

T Të gjitha defektet e shfaqura, Bashkia Tiranë do duhet t'ia bëjë prezente firmës zbatuese të punimeve, e cila duhet të kryejë riparimet e nevojshme, për të mos pritur degradimin e mëtejshëm të saj (fondi garancisë së punimeve të objektit është 5% e vlerës së situacionit përfundimtar).

Konkluzione ne lidhje me objektin:

- *Të bëhet riparimi i pllakave të thyera apo të shkëputura nga rruga kryesore, duke zëvendësuar të gjitha pllakat e gurit dhe të riparohen disa ulje të vogla të evidentuara;*
- *Bashkia para se të miratojë kryerjen e investimit, siç është edhe ndërtimi i kësaj rruge me veshje pllakash guri, duhet të jap të gjitha argumentet e plota (të domosdoshme), se cili është qëllimi që ka investuar për këtë tipologji rruge, e cila vetëm në një vështrim të përgjithshëm, ka kushtuar rreth 3 herë më shumë nga mesatarja e çmimit të rrugës, sikur ajo të ndërtohej me shtresë asfalti;*
- *Jemi të mendimit se nuk ka një studim të mirëfilltë fizibiliteti për leverdinë ekonomike për ndërtimin e këtij modeli rruge në qytetin e Tiranës.*

Për të gjitha vërejtjet e mësipërme jemi mbështetur në nenet e praktikave standarde të kontratave të zbatimit të punimeve, si edhe në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 3, datë

15.01.2001, nr. 2, datë 13.05.2005 dhe nr. 1, datë 16.06.2011, "Për mbikëqyerjen dhe kontrollin e punimeve të ndërtimit".

Bashkëlidhur nje foto ajrore e bllokut të banimit ku është investuar

